



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE TRANSPORTIT
MINISTRIJSVO INFRASTRUKTURE I TRANSPORTA
MINISTRY OF INFRASTRUCTURE AND TRANSPORTATION

Njësia org. _____ Nr. i Prot. _____
Org. Jedinica _____ Broj Prot. _____
Org. Unit _____ Prot. No. _____

Nr. i Faqe e _____ Data: _____
Br. Stranica _____ Datum: _____
No. Pages _____ Date: _____

PRISHTINE/A

Republika e Kosovës - Republika Kosova
Komuna e Gjakovës - Opština Djakovica
Drejtoria për Punë të Përgjithshme Administrative
Uprava za Opšte, Administrativne Poslove

Br. 413/17-11772
Data/Datum 12.05.2017
Gjakovë-Djakovica-Gjakova

KOMUNA E GJAKOVËS

MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS

Në mbështetje të nenit 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare, Nr. 7/01 Mars, 2019), nenit 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.4 dhe Shtojcës 1 pika 10 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 5 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, (Gazeta Zyrtare, Nr. 28/04 Qershor 2008), nenit 22 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare, Nr. 18/2012, dt. 03 Korrik 2012) si dhe nenit 17 të Udhëzimit Administrativ (MMPH) Nr. 02/2018 për Taksat Administrative për Leje Ndërtimore, Leje Rrërimi dhe Tarifat për Rregullimin e Infrastrukturës, palët e kësaj marrëveshje:

1. Komuna e Gjakovës të cilën e përfaqëson Kryetari i Komunës Ardian Gjini, në tekstin vijues Komuna;

dhe

2. Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, të cilën e përfaqëson Ministri Liburn Aliu, në tekstin vijues Ministria.

lidhin këtë:

MARRËVESHJE MIRËKUPTIMI

Neni 1 Qëllimi

Me këtë Marrëveshje Mirëkuptimi konfirmohet qëllimi dhe vullneti i Komunës së Gjakovës për përmbushjen e obligimeve financiare për realizimin e projektit “Ndërtimi i Impiantit për Ngrohje nga Biomasa me Teknologjinë e Gjenerimit – CHP në Gjakovë” sipas dispozitave ligjore të parapara në Ligjin Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe Udhëzimin Administrativ (MMPH) Nr. 02/2018 për Taksat Administrative për Leje Ndërtimore, Leje Rrërimi dhe Tarifat për Rregullimin e Infrastrukturës.

Neni 2 Objekti i Marrëveshjes

Realizimi i pagesës nga Komuna e Gjakovës sipas Zotimit të dt. 14.11.2019 në emër të taksës për leje ndërtimore sipas faturës Nr. 000013 të lëshuar nga ish MMPH për projektin “Ndërtimi i Impiantit për Ngrohje nga Biomasa me Teknologjinë e Gjenerimit – CHP në Gjakovë” të financuar nga Programi IPA II (2015) të Zyrës së Bashkimit European dhe lëshimi i Certifikatës së Përdorimit nga Ministria.

Neni 3
Obligimet e Komunës

Komuna e Gjakovës si aksionare e 100% e Ngrohtores së Qytetit Gjakova Sh.A, obligohet të bëjë pagesën në vlerë prej 30,759.63€, pas rishikimit të buxhetit të vitit financiar 2021 për taksën për Leje Ndërtimore e përcaktuar sipas procedurave për llogaritjen dhe caktimin e taksës për Leje Ndërtimore, konform dispozitave ligjore të parapara në legjislacionin në fuqi.

Neni 4
Obligimet e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, si organ kompetent obligohet të përfundoj procedurat dhe lëshoj me kusht certifikatën e përdorimit pas nënshkrimit të kësaj marrëveshje.

Neni 5
Zgjidhja e marrëveshjes

Në rast të mos përmbushjes së obligimit nga Komuna e Gjakovës sipas nenit 3 të kësaj Marrëveshje Ministria mban të drejtën e revokimit të Certifikatës së Përdorimit.

Neni 6
Numri i kopjeve

Kjo Marrëveshje Mirëkuptimi është përpiluar në katër (4) ekzemplarë të njëjtë, prej të cilëve nga dy (2) ekzemplarë i marrin palët nënshkruese.

Neni 7
Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje Mirëkuptimi paraqet vullnetin e lirë të palëve nënshkruese, të cilat zotohen se të njëjtin do ta zbatojnë me përpikëri dhe në pajtim me kornizën ligjore në fuqi, ndërsa obligimet e palëve rrjedhin pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshje.

Prishtinë, 30.04.2021

Komuna e Gjakovës


Ardian Gjini



Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës


Liburn Aliu

